

<ol style="list-style-type: none"> 1. Fjalori i termave të përdorur në politikën e konkurrencës së BE-së: Antitrust dhe kontrolli i përqendrimeve 2. Direktiva (BE) 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 8 qershor 2016 për mbrojtjen e njohurive të pazbuluara dhe informacionit të biznesit (sekretet tregtare) kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm të tyre 3. Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, neni 101 dhe 102 4. Rregullorja e Këshillit Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve 5. Rregullorja e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit” 		<p>Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”</p> <p>Shkalla e përafrimit në total e projekt-aktit:</p> <p>Përputhshmëri e pjesshme</p>				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
			Neni 1	<p style="text-align: center;">Qëllimi i ligjit</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme të sjelljes së ndërmarrjeve private e publike që kryejnë veprimtari ekonomike, për garantimin e konkurrencës së lirë e efektive dhe nxitjen e efijencave</p>		Rregullim që ndihmon në zbatimin e projektligjit

				ekonomike në tregun e brendshëm si dhe përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësive të institucionit përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.		
Fjalori i termave të përdorur në politikën e konkurrencës së BE-së: Antitrust dhe kontrolli i përqendrimeve, "Praktikë e bashkërenduar"	Koordinimi ndërmjet ndërmarrjeve të cilat, pa arritur në fazën e lidhjes së një marrëveshjeje formale, bashkëpunojnë me vetëdije në praktikë duke kufizuar, deformuar ose shtrembëruar konkurrencën në treg. Një praktikë e bashkërenduar mund të krijohet nga komunikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë midis ndërmarrjeve, qëllimi ose pasoja i të cilit është të ndikojë në sjelljen e tregut ose të zbulojë sjelljen e synuar në të ardhmen për konkurrentët.		Neni 2	<p style="text-align: center;">Përkufizime</p> <p>“Praktikë e bashkërenduar” është koordinimi ndërmjet ndërmarrjeve të cilat, pa arritur në fazën e lidhjes së një marrëveshjeje formale, bashkëpunojnë me vetëdije në praktikë duke kufizuar, deformuar ose shtrembëruar konkurrencën në treg. Një praktikë e bashkërenduar mund të krijohet nga komunikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë midis ndërmarrjeve, qëllimi ose pasoja i të cilit është të ndikojë në sjelljen e tregut ose të zbulojë sjelljen e synuar në të ardhmen për konkurrentët.</p>	E plotë	
Fjalori i termave të përdorur në politikën e konkurrencës së BE-së: Antitrust dhe kontrolli i	Forma e veçantë e koordinimit ndërmjet ndërmarrjeve që mund të ndikojë negativisht në rezultatin e çdo procesi		Neni 2	“Marrëveshje në oferta” është ajo marrëveshje ku ndërmarrjet gjatë procedurave të prokurimit publik, nuk konkurrojnë midis tyre por bien dakord fshehurazi për të caktuar	E pjeshme	

<p>përqendrimeve, “Marrëveshje në oferta”</p>	<p>prokurimi publik për shitje ose blerje. Për shembull, ndërmarrjet mund të bien dakord paraprakisht me ofertat e tyre, duke vendosur se cila ndërmarrje do të jetë ofertuesi më i ulët. Përndryshe, ata mund të bien dakord të mos ofrojnë ose të ndryshojnë ofertat e tyre sipas numrit ose vlerës së kontratave.</p>			<p>çmimet ose për të ulur cilësinë e mallrave, punëve ose shërbimeve për blerësit që dëshirojnë të prokurojnë produkte, shërbime ose punë nëpërmjet një procedure prokurimi apo kur bien dakord të koordinojnë ofertat e tyre në prokurimet publike në një nga format e mëposhtme:</p> <p>i) ofertë e mbuluar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kur konkurrentët pranojnë të paraqesin ofertë më të lartë sesa oferta e fituesit të përcaktuar: - njëri nga konkurrentët pranon të ofertojë me një shumë e cila është shumë e madhe për t’u pranuar si ofertë. - njëri nga konkurrentët paraqet një ofertë e cila përmban terma specifike të cilat janë të paparanueshme nga Autoriteti Kontraktor. <p>ii) ofertë e përmbajtur, është ajo ofertë ku konkurrentët bien dakord që të mos ofertojnë apo të tërhiqen nga një ofertë e paraqitur në mënyrë që oferta e përcaktuar fituese në marrëveshje të pranohet si e tillë;</p> <p>iii) ofertë në rotacion, është ajo ofertë kur konkurrentët merren</p>		
---	--	--	--	---	--	--

				<p>vesh të ofertojnë, duke rënë dakord paraprakisht që fituesi të jetë njëri prej tyre sipas një rradhe të caktuar;</p> <p>iv) ndarje e tregut, fenomen i cili ndodh kur konkurrentët ndajnë në pjesë tregun dhe bien dakord që të mos konkurrojnë për një pjesë të caktuar konsumatorësh, ose një pjesë të caktuar gjeografike.</p>		
<p>Direktiva (BE) 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 8 qershor 2016 për mbrojtjen e njohurive të pazbuluara dhe informacionit të biznesit (sekretet tregtare) kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm të tyre, Neni 2 “Përkufizime”, pika 1</p>	<p>“Sekret tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:</p> <p>a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;</p> <p>b) ka vlerë tregtare, sepse, është sekret;</p> <p>c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga</p>		<p>Neni 2</p>	<p>“Sekret tregtar” është informacioni që përmbush kërkesat e mëposhtme:</p> <p>a) është sekret në kuptimin që në tërësinë e tij ose për sa i përket konfigurimit të saktë dhe kombinimit të pjesëve përbërëse të tij, nuk është gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm për personat që përgjithësisht merren me llojin e informacionit në fjalë;</p> <p>b) ka vlerë tregtare, sepse, përsa kohë nuk njihet nga të tjerët, i siguron ndërmarrjes një avantazh konkurrencial;</p> <p>c) u është nënshtruar hapave të arsyeshëm për ruajtjen e informacionit, sipas rrethanave, nga personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.</p>	<p>E plotë</p>	

	personi që zotëron në mënyrë të ligjshme informacionin për të mbajtur sekretin të fshehtë.					
Traktati për Funksionimin e Bashkimit European, Neni 101, paragrafi 1 dhe 2	<p>1. Sa më poshtë janë të ndaluara si të papajtueshme me tregun e brendshëm: të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet e shoqatave të ndërmarrjeve dhe praktikatat e bashkërenduara të cilat mund të prekin tregtinë midis Shteteve Anëtare dhe të cilat kanë si objekt ose pasojë të tyre pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të brendshëm dhe, në veçanti, ato të cilat:</p> <p>(a) vendosin drejtpërdrejt ose tërthorazi çmimet e shitjes e të blerjes ose çdo kusht tjetër tregtimi;</p> <p>(b) kufizojnë ose mbajnë në kontroll prodhimin,</p>		Neni 3	<p>Marrëveshjet e ndaluara</p> <p>1. Ndalohen të gjitha marrëveshjet, të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, veçanërisht marrëveshjet që:</p> <p>a) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi;</p> <p>b) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;</p> <p>c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;</p> <p>ç) në marrëdhëniet tregtare me palët e tjera, zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;</p> <p>d) kushtëzojnë lidhjen e kontratave me pranimin nga palët e tjera kontraktuese të detyrimeve shtesë</p>	E plotë	

	<p>tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;</p> <p>(c) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;</p> <p>(d) zbatojnë kushte jo të njëjta për transaksione të barasvlefshme me palë të tjera tregtare, duke i vendosur ato në pozitë të pafavorshme konkurruese;</p> <p>(e) lidhjen e kontratave e kushtëzojnë me pranimin nga ana e palëve të tjera e detyrimeve shtesë të cilat, për nga natyra ose për nga përdorimi tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave të tilla.</p> <p>2. Çdo marrëveshje apo vendim i cili është i ndaluar në zbatim të këtij neni, është automatikisht pa vlerë ligjore.</p>			<p>që, për nga natyra ose nga përdorimi i tyre tregtar, nuk kanë lidhje me objektin e këtyre kontratave;</p> <p>dh) përbëjnë një nga format e marrëveshjes në oferta, në procedurat e prokurimit publik sipas nenit 3, pika 11 të ligjit.</p> <p>2. Marrëveshjet që ndalohen, sipas pikës 1 të këtij neni dhe që nuk përjashtohen sipas neneve 5 dhe 7, janë të pavlefshme.</p>		
			Neni 4	Ftesë për marrëveshje të ndaluar		Në përputhje të plotë me nenin 1A ³ “Ftesë për marrëveshje të ndaluar” të ligjit

				<p>1. Është e ndaluar për një ndërmarrje të propozojë, të detyrojë, të motivojë ose në çfarëdo mënyrë të ftojë një ndërmarrje tjetër për të marrë pjesë në një marrëveshje midis ndërmarrjeve ose në vendimet e grupimeve të ndërmarrjeve ose në praktika të bashkërenduara që synojnë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës, siç parashikohen në nenit 4 të ligjit.</p> <p>2. Praktikrat sipas pikës 1 të këtij neni, nuk ndalohen kur plotësojnë kushtet e nenit 5 të këtij ligji.</p>		<p>grek nr. 3959/2011 “Për mbrojtjen e konkurrencës së lirë”</p>
<p>Traktati për Funksionimin e Bashkimit Europian, Neni 101, paragrafi 3</p>	<p>3. Por dispozitat e paragrafit 1 mund të deklarohen si të pazbatueshme në rast të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – çdo marrëveshjeje ose kategorie marrëveshjesh midis ndërmarrjeve, – çdo vendimi ose kategorie vendimesh të shoqatave të ndërmarrjeve, – çdo praktike të bashkërenduar ose kategorie praktikash të bashkërenduara, që kontribuon në 		<p>Neni 5</p>	<p>Përrjashtimi i marrëveshjeve</p> <p>1. Mund të përjashtohet nga zbatimi i pikës 1 të nenit 4 çdo marrëveshje apo kategori marrëveshjesh, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik, nëse një pjesë e mjaftueshme e këtyre përfitimeve shkon në favor të klientëve e të konsumatorëve dhe kur:</p> <p>a) Nuk përmban kufizime të veprimtarive të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, që nuk janë të</p>	<p>E plotë</p>	<p>Bashkim i neneve 5 dhe 6 të ligjit aktual</p>

	<p>përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjen e mallrave, ose në nxitjen e përparimit teknik, ose ekonomik, duke u lejuar konsumatorëve të kenë një pjesë të drejtë të përfitimit që rrjedh prej kësaj, dhe që:</p> <p>(a) nuk vendos mbi ndërmarrjet në fjalë kufizime që nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;</p> <p>(b) nuk u jep ndërmarrjeve mundësinë për ta eliminuar konkurrencën në lidhje me një pjesë të konsiderueshme të produkteve në fjalë.</p>			<p>domosdoshme për të arritur objektivat e sipërpërmendur;</p> <p>b) Nuk kufizon, në mënyrë të ndjeshme, konkurrencën në lidhje me produktet apo shërbimet, objekt i këtyre marrëveshjeve.</p> <p>2. Komisioni miraton rregullore për kategoritë e marrëveshjeve që përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 4. Në këto rregullore përcaktohen me hollësi kushtet që duhet të përmbushin marrëveshjet, për të përfituar nga përjashtimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 4.</p>		
			Neni 6	Neni 6 “Përjashtimi i kategorive të marrëveshjeve” shfuqizohet		
Rregullorja e Këshillit Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 Mbi kontrollin e	1. Një përqendrim do të konsiderohet se lind kur shkaktohet një ndryshim		Neni 7	<p>Përqendrimi i ndërmarrjeve</p> <p>1. Përqendrim të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një</p>		

<p>përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, neni 3 “Përkufizimi i përqendrimeve”</p>	<p>i qëndrueshëm i kontrollit, si rrjedhojë e:</p> <p>(a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra, ose</p> <p>(b) përfitimit, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm, të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjese të këtyre të fundit.</p> <p>2. Kontrolli mund të përfitohet nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të cilat, më vete ose të kombinuara dhe, duke marrë parasysh rrethanat</p>			<p>ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit, si rrjedhojë e:</p> <p>a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra-tjetra;</p> <p>b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrjeje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje, ose të një pjese të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave apo asetëve, kontratës ose çdo mjeti tjetër të ligjshëm;</p> <p>c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit.</p> <p>ç) krijimit të një ndërmarrje të përbashkët (joint-venture) nga dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura, e cila funksionon mbi baza të përhershme si një ndërmarrje e pavarur ekonomike.</p> <p>2. Kontrolli, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, mund të përfitohet nëpërmjet të drejtave, kontratave ose çdo mënyre tjetër, të</p>	<p>E plotë</p>	
--	--	--	--	---	----------------	--

	<p>e faktit ose të ligjit, krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi një ndërmarrje, në veçanti, me anë të:</p> <p>(a) së drejtës së pronës ose të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje;</p> <p>(b) të drejtat ose kontratat që japin ndikim vendimtar në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve të një ndërmarrjeje.</p> <p>3. Kontrolli merret nga persona ose ndërmarrje të cilat:</p> <p>(a) janë mbajtës të të drejtave ose kanë të drejta sipas kontratave në fjalë; ose</p> <p>(b) edhe pse nuk janë mbajtës të këtyre të drejtave ose nuk kanë të drejta sipas kontratave të tilla, kanë fuqinë për të</p>			<p>cilat, më vete ose të kombinuara dhe, duke marrë parasysh rrethanat e faktit ose të ligjit, krijojnë mundësinë e ushtrimit të një ndikimi vendimtar mbi veprimtarinë ekonomike të një ndërmarrjeje, në veçanti, me anë të:</p> <p>a) së drejtës së pronës ose të së drejtës për të përdorur të gjitha ose një pjesë të aktiveve të një ndërmarrjeje;</p> <p>b) të drejtave ose kontratave, që ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në përbërjen, votimin ose vendimet e organeve drejtuese të një ndërmarrjeje.</p> <p>3. Krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët nuk përbën një përqendrim, sipas këtij neni, në rast se ka për objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura. Në këtë rast, krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët vlerësohet në bazë të nenit 4 të këtij ligji.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>ushtruar të drejtat që rrjedhin prej tyre.</p> <p>4. Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët (joint-venture) nga dy ose më shumë ndërmarrje të pavarura, e cila funksionon mbi baza të përhershme si një ndërmarrje e pavarur ekonomike do të përbëjë një përqendrim sipas kuptimit të paragrafit 1(b).</p>					
			<p>Neni 8</p>	<p>Kontrolli i përqendrimeve</p> <p>1. Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet për të marrë autorizim, nëse, në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:</p> <p>a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun ndërkombëtar është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.</p>		<p>Pika 4 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit</p>

			<p>b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrjeje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë.</p> <p>2. Përqendrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni njoftohen brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim, për përftim kontrolli ose për krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët, si dhe nga publikimi i ofertës publike për blerje ose shkëmbim.</p> <p>3. Ndërmarrje pjesëmarrëse, në kuptimin e këtij neni, janë:</p> <p>a) në rast bashkimi, ndërmarrjet që bashkohen;</p> <p>b) në rast përftimi kontrolli, ndërmarrjet dhe/ose personat e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 10, që përftojnë kontrollin, dhe ndërmarrjet ose pjesët e ndërmarrjeve, që bëhen objekt të përftimit të kontrollit;</p> <p>c) në rast krijimi të një ndërmarrjeje të përbashkët, sipas pikës 1 të nenit</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>10, ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.</p> <p>4. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson kryesisht përqendrimet e të gjitha ndërmarrjeve të cilat, brenda një periudhe dy vjeçare nga momenti i lidhjes së marrëveshjes për bashkim, përfitim kontrolli apo krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët, plotësojnë kriterin e kufirit të xhiros, megjithëse në momentin e lidhjes së marrëveshjes nuk përmbushnin kriteret për njoftim sipas këtij ligji.</p>		
			Neni 9	<p>Komisioni i Konkurrencës</p> <p>Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës i Autoritetit dhe përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët të paktën dy të jenë të profilit juridik dhe dy të profilit ekonomik.</p> <p>Ai vepron si një organ kolegjal i përhershëm.</p>		Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit
			Neni 10	<p>Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Komisionit</p>		Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit

				<p>Anëtar i Komisionit mund të zgjidhet kandidati që plotëson kushtet e mëposhtme:</p> <p>a) të jetë shtetas shqiptar;</p> <p>b) të ketë vjetërsi pune jo më pak se 15 vjet, të jetë dalluar profesionalisht dhe të ketë integritet të lartë moral në profesionin e juristit apo të ekonomistit;</p> <p>c) të ketë jo më pak se 5 vite eksperiencë pune pranë një institucioni të arsimit të lartë universitar ose të mbajë gradën shkencore Doktor i Shkencave në fushën e drejtësisë apo ekonomisë;</p> <p>ç) të mos jetë larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore.</p>		
			Neni 11	<p style="text-align: center;">Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit</p> <p>1. Anëtarët e Komisionit zgjidhen me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me kandidatura alternative si më poshtë;</p>		Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit

				<p>a) një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës;</p> <p>b) dy anëtarë propozohen nga Kuvendi i Shqipërisë;</p> <p>c) dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave.</p> <p>2. Anëtarët e Komisionit zgjidhen për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhje vetëm 1 herë.</p> <p>3. Kuvendi, zgjedh Kryetarin e Komisionit, ndërmjet anëtarëve jurist, mandati i të cilit zgjat deri në përfundim të mandatit si anëtar. Zëvendëskryetari zgjidhet nga anëtarët e Komisionit.</p> <p>4. Tre muaj para përfundimit të mandatit të çdo anëtarit të komisionit, Autoriteti njofton me shkrim Kuvendin, i cili fillon praktikat për zgjedhjen e anëtarit të ri. Në rastet kur mandati i Komisionerit ka përfunduar dhe nuk është realizuar emërimi i anëtarit të ri, anëtari i vjetër qëndron në detyrë deri në zëvendësimin e tij.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			Neni 12	<p style="text-align: center;">Konflikti i interesave</p> <p>1. Kryetari, Zëvendëskryetari ose çdo anëtar tjetër i Komisionit nuk merr pjesë në shqyrtimin e një çështjeje për të cilën ai ka interes ose kur ka përfaqësuar njërën nga palët pjesëmarrëse. Në këtë rast, Komisioni e merr vendimin në mungesë të Kryetarit, Zëvendëskryetarit ose anëtarit në fjalë.</p> <p>2. Rastet e gjendjes në konflikt interesi të Anëtarëve të Komisionit dhe punonjësve të Autoritetit të cilët janë përfshirë në zhvillimin e procedurës deri në miratimin e vendimit të Komisionit, parashikohen dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave.</p>		Pika 2 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit
			Neni 13	<p style="text-align: center;">Ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekreteve tregtare</p> <p>1. Anëtarët e Komisionit dhe të gjithë punonjësit e Autoritetit ose personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni për zbatimin e këtij ligji,</p>		Në përputhje të plotë me nenin 53 “Ruajtja e konfidencialitetit” të Aktit Kroat të Konkurrencës, datë 24.4.2021, FL 41/21

			<p>ruajnë sekretin profesional dhe nuk u japin të dhëna konfidenciale, të siguruara gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se Autoriteti mund të ekspozojë kategoritë e mëposhtme të provave:</p> <p>a) informacionin e përpiluar nga një person fizik ose juridik posaçërisht për procedimet përpara Autoritetit të Konkurrencës,</p> <p>b) informacionin që Autoriteti ka hartuar dhe iu ka transmetuar palëve gjatë hetimeve të tij,</p> <p>c) marrëveshjet apo deklaratat nga të cilat palët janë tërhequr.</p> <p>2. Provat e gjendura në dosjet e Autoritetit të Konkurrencës do të ekspozohen vetëm me vendim përfundimtar të formës së prerë të një gjykate dhe vetëm në ato raste kur këto prova nuk merren pranë një institucioni tjetër publik ose një pale tjetër të tretë me përpjekje të arsyeshme. Dokumentet e brendshme të Autoritetit të Konkurrencës, korrespondenca me autoritetet e tjera të konkurrencës dhe ndërmjet autoritetit të</p>	<p>dhe nenin 13a “Zbulimi i provave nga Autoriteti Federal i Konkurrencës” të Aktit Austriak të Konkurrencës, versioni i konsoliduar, FL 33/2023</p>
--	--	--	---	--

			<p>konkurrencës dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit si dhe kërkesat e marrëveshjet për lehtësimin nga gjobat nuk do të zbulohen në asnjë moment.</p> <p>Kjo vlen dhe pas mbarimit të detyrës.</p> <p>3. Publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret tregtar.</p> <p>4. Sekreti tregtar në kuptim të këtij neni është:</p> <p>a) gjithçka që përcaktohet si sekret tregtar sipas përkufizimit të nenit 2, pika 12 të këtij ligji</p> <p>b) gjithçka që është përcaktuar si sekret tregtar nga ndërmarrja nëse pranohet si i tillë nga Autoriteti në kuptim të këtij ligji.</p> <p>5. Autoriteti merr parasysh kriteret e mëposhtme, por jo vetëm, për të përcaktuar nëse informacioni mund të përbëjë sekret tregtar:</p> <p>a) masën në të cilën informacioni është i njohur jashtë ndërmarrjes;</p> <p>b) masën në të cilën janë marrë masa për mbrojtjen e informacionit brenda ndërmarrjes;</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>c) vlerën e informacionit për ndërmarrjen dhe konkurrentët e saj.</p> <p>6. Nuk konsiderohet sekret tregtar:</p> <p>a) informacioni që është i disponueshëm publikisht, duke përfshirë informacionin e disponueshëm nëpërmjet shërbimeve të specializuara të informacionit ose informacionin që është i njohur nga specialistët e fushës;</p> <p>b) informacioni historik, në veçanti informacioni i cili ka jetëgjatësi të paktën 5 vjet, pavarësisht nëse është konsideruar si sekret tregtar, sipas përcaktimeve të akteve nënligjore të Komisionit të Konkurrencës mbi konfidencialitetin dhe aksesin në dosje.</p> <p>c) informacion vjetor dhe statistikor. Xhiro vjetore normalisht nuk konsiderohet si sekret tregtar, pasi është një shifër e publikuar në llogaritë vjetore ose e njohur ndryshe në treg;</p> <p>d) të dhënat dhe dokumentacioni mbi të cilin bazohet vendimi i Autoritetit.</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>7. Me përjashtim të gërmës “a” dhe “b” të pikës 4 të këtij neni, kur ndërmarrja i dorëzon Autoritetit dokumentacion i cili ka në përbërje të tij të dhëna konfidenciale dhe nuk ofron versionin jo konfidencial të dokumentacionit përkatës apo të të dhënave që nuk përmbajnë informacion konfidencial ose sekret tregtar, Autoriteti, pasi t'i ketë dërguar një shkresë ndërmarrjes në fjalë, përfundimisht do të supozojë se një dokumentacion i tillë nuk përmban të dhëna lidhur me sekretin tregtar.</p>	
			Neni 14	<p style="text-align: center;">Financimi i Autoritetit</p> <p>1. Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë me vete në Buxhetin e Shtetit, miratohet nga Kuvendi.</p> <p>2. Të ardhurat nga gjobat, që krijohen në zbatim të këtij ligji, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe përdoren sipas akteve ligjore në fuqi.</p> <p>3. Të ardhurat që krijohen nga procedurat e kontrollit të përqendrimeve, tarifat administrative për kontrollin e përqendrimeve dhe autorizimet e</p>	<p>Pika 2 dhe 3 janë masa të brendshme kombëtare që ndihmojnë në zbatimin e projektligjit</p>

				<p>përqendrimeve, sipas përcaktimeve të neneve 10, 12, 56, 57, 60 dhe 61 të këtij ligji, si dhe të ardhurat që krijohen nga procedurat e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve sipas përcaktimeve të neneve 5, 7, 48 dhe 50 të këtij ligji, derdhen në llogarinë e Autoritetit. Këto të ardhura do të përdoren për qëllime investimi dhe shpenzime operative, të cilat kontribuojnë në përmbushjen e misionit të institucionit, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës.</p> <p>4. Autoriteti mban llogari të shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike, në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit.</p>		
			Neni 15	<p>Detyrimi për organet e administratës publike</p> <p>Organet e administratës qendrore e vendore dhe institucionet e tjera publike janë të detyruara të bashkëpunojnë me Autoritetin për</p>		Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit

				sigurimin e të dhënave dhe të provave të nevojshme, brenda afateve të kërkuara nga Autoriteti.	
			Neni 16	<p>Përgjegjësitë për inspektim</p> <p>1. Inspektorët e Autoritetit kryejnë inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve dhe grupimeve të ndërmarrjeve, sipas objektit dhe procedurave të parashikuara në këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.</p> <p>2. Komisioni, me kërkesën e Sekretariatit, autorizon me shkrim inspektorët e Autoritetit për kryerjen e inspektimeve, sipas procedurave të parashikuara në këtë ligj. Për të kryer inspektimin, inspektorët e Autoritetit paraqesin autorizimin, i cili përmban objektin dhe qëllimin e inspektimit, si dhe sanksionet e parashikuara në nenet 73, 74, 76 dhe 78 të këtij ligj.</p> <p>3. Autoriteti kërkon ndihmën e Policisë së Shtetit në rastet kur pengohet kryerja e inspektimeve të nevojshme.</p> <p>4. Autoriteti mund të kërkojë ndihmën e inspektorëve të organeve tatimore gjatë kryerjes së inspektimeve.</p>	Pika 4 është në përputhje të plotë me nenin 14 “Hetimi” të ligjit italian nr. 287, datë 10 tetor 1990 “Rregulla për mbrojtjen e konkurrencës dhe të tregut”

			Neni 17	<p style="text-align: center;">Inspektimi në ndërmarrje</p> <p>1. Inspektorët e Autoritetit dhe persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Komisioni për kryerjen e inspektimeve mund:</p> <p>a) të hyjnë në mjediset, mjetet e transportit dhe në territorin e ndërmarrjeve, gjatë orarit të punës;</p> <p>b) të shqyrtojnë librat dhe regjistrat e veprimtarisë ekonomike dhe dokumentet e tjera, pavarësisht nga mënyra e ruajtjes së këtij dokumentacioni, në formë të shkruar ose elektronike;</p> <p>c) të marrin ose të sigurojnë kopje ose pjesë nga këto libra, regjistra ose dokumente;</p> <p>ç) të vulosin çdo seli, libër ose regjistër të veprimtarisë ekonomike për jo më shumë se 72 orë, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për inspektimin;</p> <p>d) t'i kërkojnë çdo përfaqësuesi ose punonjësi të ndërmarrjes shpjegime për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit.</p>		
--	--	--	---------	--	--	--

			Neni 18	<p style="text-align: center;">Kontrolli në mjedise të tjera</p> <p>1. Inspektorët e Autoritetit, të autorizuar me vendim nga gjykata që ka në juridiksion vendin ku kryhet kontrolli, mund të hyjnë:</p> <p>a) në banesat e administratorëve, menaxherëve, drejtorëve dhe punonjësve të tjerë të ndërmarrjes, si dhe në banesat e selitë e veprimtarisë ekonomike të personave fizikë dhe juridikë, të brendshëm ose të jashtëm, të ngarkuar për menaxhimin tregtar, kontabël, administrativ, fiskal ose financiar nga ora 7⁰⁰ deri në orën 18⁰⁰;</p> <p>b) në mjedise të tjera, të njësuar me banesat, kur ka arsye të bazuara për fakte dhe rrethana konkrete se në këto mjedise gjenden ditare ose dokumente të tjera profesionale, që mund të jenë të nevojshme për të vërtetuar shkeljet e neneve 4 dhe 9 të këtij ligji.</p> <p>2. Inspektorët e Autoritetit të autorizuar me vendim të Komisionit për kryerjen e kontrollit, veprojnë sipas nenit 36</p>		Pika 3 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit
--	--	--	---------	---	--	--

				<p>shkronjat "a", "b", "c" dhe "d" dhe nenit 39 të këtij ligj.</p> <p>3. Kur gjatë kryerjes së inspektimeve, konstatohen ose ka dyshime për ekzistencën e elementëve që mund të përbëjnë kundravajtje administrative ose vepër penale, Autoriteti referon rastin pranë organeve kompetente.</p>	
			Neni 19	<p>Ankimi ndaj vendimeve</p> <p>1. Kundër vendimeve të Autoritetit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimi i vendimit, me përjashtim të rastit përveç përjashtimit të parashikuar në nenin 42, pika 4 të këtij ligji.</p> <p>2. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimeve që autorizojnë përqendrimet dhe marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44 të këtij ligji.</p> <p>3. Gjykata mund të vendosë pezullimin, tërësisht ose pjesërisht, të këtyre masave.</p>	Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit
			Neni 20		Pika 2 është masë e brendshme kombëtare që

				<p style="text-align: center;">Hetimi i përgjithshëm</p> <p>1. Autoriteti, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatore të sektorëve përkatës, mund të kryejë një hetim të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, nëse ngurtësia e çmimeve ose rrethana të tjera të bëjnë të mendosh se konkurrenca në treg kufizohet ose shtrembërohet.</p> <p>2. Autoriteti ka akses në bazën e të dhënave sipas marrëveshjeve përkatëse me institucionet e mëposhtme:</p> <p>a) Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;</p> <p>b) Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave;</p> <p>c) Qendrës Kombëtare të Biznesit;</p> <p>d) Agjencisë së Prokurimit Publik.</p> <p>2/1. Autoriteti mund t'u kërkojë ndërmarrjeve ose grupimeve të ndërmarrjeve që t'i sigurojnë të gjitha informacionet e nevojshme për kryerjen e hetimit.</p>	<p>ndihmon në zbatimin e projektligjit</p>
--	--	--	--	---	--

				<p>3. Autoriteti mund të publikojë një raport për rezultatet e hetimit të përgjithshëm në një sektor të ekonomisë, si dhe mund të ftojë palët e interesuara të shprehen për rezultatet e hetimit.</p> <p>4. Parashikimet e neneve 33 e 34 të këtij ligji zbatohen edhe për pikën 2/1 të këtij neni.</p>		
			Neni 21	<p style="text-align: center;">Hetimi paraprak</p> <p>1. Sekretariati, me miratimin e komisionit, mund të fillojë hetimin paraprak, me nismën e tij, me ankesë të palëve të interesuara ose të treta, për kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës. Sekretariati fillon hetimin paraprak, sa herë që kërkohet nga komisioni.</p> <p>2. Gjatë hetimit paraprak nuk nënkuptohet e drejta për të konsultuar dosjet.</p> <p>3. Autoriteti ruan mbetjen anonim të ankuesit, sa herë që ky i fundit e paracakton një gjë të tillë.</p> <p>4. Kundër vendimit të Komisionit për fillimin e hetimit paraprak, nuk mund të bëhet ankim administrativ në gjykatë.</p>		Pika 4 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit

			Neni 22	<p style="text-align: center;">Hetimi i thelluar</p> <p>1. Kur vihen re shenja të kufizimit të konkurrencës, fillohet procedura e hetimit të thelluar. Komisioni merr vendim për fillimin e procedurës së hetimit të thelluar dhe përcakton hapat për realizimin e tij. Vendimi zbatohet nga Sekretariati i Autoritetit.</p> <p>2. Afati i përfundimit të procedurave të hetimit të thelluar është deri në 6 muaj nga data e vendimit të komisionit për hapjen e hetimit të thelluar.</p> <p>3. Afati, sipas pikës 2 të këtij neni, mund të zgjatet me vendim të komisionit, në rast se kërkohen hetime të mëtejshme, që kanë të bëjnë me prova, të dhëna shtesë dhe ekspertizë të specializuar për shqyrtimin e rastit.</p> <p>4. Procedurat hetimore, të parashikuara në nenet 41, 42 e 43 të këtij ligji, kryhen sipas rregulloreve të dala në zbatim të këtij ligji.</p> <p>5. Komisioni shprehet me vendim për mbylljen e hetimit, në zbatim të neneve 41, 42 e 43 të këtij ligji, edhe në rastet kur nuk konstatohen</p>		Formulim më i qartë
--	--	--	---------	---	--	---------------------

				shenja të kufizimeve të konkurrencës.		
			Neni 23	<p style="text-align: center;">Anulimi dhe shfuqizimi vendimeve</p> <p>Komisioni mund të anulojë apo shfuqizojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:</p> <p>a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;</p> <p>b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;</p> <p>c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.</p>		Formullim më i saktë
			Neni 24	<p style="text-align: center;">Përgjegjësitë për dhënien e përjashtimeve</p> <p>Komisioni është i vetmi organ përgjegjës për të vendosur dhënien e përjashtimeve, të parashikuara në nenet 5 dhe 7 të këtij ligji.</p>		Rregullim i references në nene

			Neni 25	<p style="text-align: center;">Njoftimi i marrëveshjeve</p> <p>1. Në zbatim të nenit 5 të këtij ligji, ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve njoftojnë në Autoritet marrëveshjet dhe ndryshimet e bëra në to.”.</p> <p>2. Njoftimi përmban të dhënat e mëposhtme:</p> <p>a) emërtimin e ndërmarrjeve dhe vendin e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike ose vendin e regjistrimit të ndërmarrjeve pjesëmarrëse;</p> <p>b) llojin e veprimtarisë ekonomike;</p> <p>c) formën, përmbajtjen dhe objektin e marrëveshjes;</p> <p>ç) pjesët e tregut përkatës që zënë ndërmarrjet, duke treguar metodologjinë për llogaritjen dhe vlerësimin e tyre;</p> <p>d) personin e autorizuar që përfaqëson ndërmarrjen gjatë procedurës.</p> <p>3. Njoftimi i dhënë Autoritetit, sipas kërkesës së pikave 1 e 2 të këtij neni, nuk duhet të përmbajë të dhëna të pasakta, të cilat bëhen shkak për të siguruar përjashtimin</p>		Përshtatje e nenit me ndryshimet e bëra në projektligj
--	--	--	---------	---	--	--

				<p>për palën njoftuese ose për një palë të tretë, sipas nenit 5 të këtij ligji.</p> <p>4. shfuqizohet</p>	
			Neni 26	<p style="text-align: center;">Vendimi për përjashtim nga marrëveshja</p> <p>1. Marrëveshjet e njoftuara në bazë të nenit 49 të këtij ligji, përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 5 vetëm me vendim të komisionit.</p> <p>2. Efektet e përjashtimit fillojnë nga data e njoftimit. Përjashtimet, sipas nenit 5 të këtij ligji, janë të kufizuara në kohë dhe mund t'u jepen ndërmarrjeve me kushte dhe detyrime.</p> <p>3. Nëse me vendim të komisionit refuzohet përjashtimi nga ndalimi, komisioni nuk mund të vendosë gjoba për shkeljet e shkaktuara nga kjo marrëveshje, për periudhën gjatë së cilës ajo shqyrtohet. Komisioni nuk mund të vendosë gjoba për ato ndërmarrje, të cilat kanë njoftuar marrëveshjen për periudhën nga data e njoftimit deri në marrjen e vendimit mbi përjashtimin ose jo të zbatimit të nenit 5 të këtij ligji.</p>	<p>Përshtatje e nenit me ndryshimet e bëra në projektligj</p>

				<p>4. Në bazë të një kërkesë, përjashtimet mund të shtyhen në kohë, nëse kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, vazhdojnë të plotësohen. Shtyrja mund të jepet vetëm për ndërmarrjet pjesëmarrëse, të cilat deklarojnë pëlqimin e tyre me shkrim pranë Autoritetit. Deklarata bëhet në mënyrë të pavarur nga çdo ndërmarrje dhe pranohet brenda 3 muajve para mbarimit të afatit të përjashtimit.</p> <p>5. shfuqizohet</p>		
			Neni 27	<p style="text-align: center;">Anulimi dhe shfuqizimi i përjashtimit</p> <p>1. Komisioni mund të anulojë, shfuqizojë ose të ndryshojë vendimet e tij, duke vendosur kushte ose detyrime, kur:</p> <p>a) njëri ose disa nga faktet, që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;</p> <p>b) palët shkelin një ose disa detyrime, të cilat parashikohen në vendim;</p>		Formulim më i saktë

				<p>c) vendimi është bazuar në të dhëna të pasakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit;</p> <p>ç) palët abuzojnë me përjashtimin e dhënë.</p> <p>2. Vendimi i përjashtimit mund të anulohet për rastet e pikës 1 shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të këtij neni.</p>		
			Neni 28	<p style="text-align: center;">Botimi i njoftimeve dhe vendimeve për përjashtim</p> <p>1. Kërkesat për përjashtim botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Njoftimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, një përshkrim të shkurtër të marrëveshjes dhe afatin, brenda të cilit, palë të treta mund të shprehin mendimin e tyre.</p> <p>2. Vendimet e Komisionit, të marra në mbështetje të nenit 5 të këtij ligji, botohen në “Buletinin zyrtar” të Autoritetit. Njoftimi përmban emërtimin, selinë, veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe përmbajtjen kryesore të vendimit.</p>		Rregullim i references në nene

			Neni 29	<p style="text-align: center;">Detyrimi për njoftim</p> <p>1. Kanë detyrimin për njoftim:</p> <p>a) ndërmarrjet pjesëmarrëse në bashkim;</p> <p>b) ndërmarrjet që marrin nën kontroll të gjithë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera;</p> <p>c) ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët.</p> <p>2. Njoftimi që paraqet formën e përqendrimit kryhet në bazë të udhëzimit të nxjerrë nga Autoriteti për formën e njoftimit.</p>		Përshtatje e nenit me ndryshimet e bëra në projektligj
			Neni 30	<p style="text-align: center;">Procedura paraprake</p> <p>1. Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, komisioni vendos të autorizojë përqendrimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.</p> <p>2. Nëse konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg</p>		Formulim më i saktë

				<p>ose në një pjesë të tij, Komisioni vendos:</p> <p>a) autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime;</p> <p>b) fillimin e procedurës së thelluar.</p> <p>3. Në rastin e autorizimit me kushte dhe detyrime në procedurën paraprake, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni shtyhet me dy javë, nëse ndërmarrjet pjesëmarrëse angazhohen të marrin masa për eliminimin e kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i shenjave të krijimit ose të forcimit të pozitës dominuese. Angazhimet e propozuara nga palët paraqiten pranë Autoritetit jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së njoftimit.</p> <p>4. Mungesa e komunikimit brenda këtyre afateve konsiderohet si vendim, që autorizon përqendrimin dhe mund të realizohet pa rezerva.</p>		
			Neni 31	<p>Anulimi dhe shfuqizimi i vendimit</p> <p>Komisioni mund ta anulojë apo shfuqizojë vendimin nëse:</p>		Formulim më i saktë

				<p>a) është marrë në bazë të të dhënave jo të sakta të ndërmarrjeve pjesëmarrëse;</p> <p>b) është marrë me anë të mashtrimit;</p> <p>c) ndërmarrjet pjesëmarrëse shkelin një ose disa detyrime të parashikuara në autorizim.</p>		
			Neni 32	<p style="text-align: center;">Masa e gjobës për shkeljet e lehta</p> <p>1. Komisioni vendos gjoba, në masën jo më shumë se 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, mbi ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve nëse:</p> <p>a) japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në përgjigje të kërkesës ose vendimit të komisionit, sipas nenit 33 pikat 2 e 3 të këtij ligji, ose nuk japin të dhëna brenda afatit kohor, të përcaktuar në vendimin e komisionit apo në kërkesën e sekretariatit, sipas nenit 33 pika 3 të këtij ligji;</p> <p>b) japin të dhëna të pasakta, të paplota ose të rreme në njoftimet, sipas neneve 12 e 49 të këtij ligji, ose të dhëna dhe dokumente</p>		<p>Pika 1 (e) është përshtatje e nenit me ndryshimet e bëra në projektligj.</p> <p>Pika 3 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit.</p>

			<p>plotësuese të pasakta e të paplota, sipas nenit 55 të këtij ligji;</p> <p>c) japin të paplotë librat e kërkuar ose regjistrat e tjerë të veprimtarisë së tyre ekonomike, gjatë inspektimeve, sipas nenit 36 shkronjat "b" dhe "c" të këtij ligji, ose refuzojnë të pranojnë inspektimet në mbështetje të vendimit të marrë, sipas neneve 35 pika 1 dhe 36 shkronja "a" të këtij ligji;</p> <p>ç) refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve për faktet dhe, sipas shkronjës "d" të nenit 36 të këtij ligji, japin përgjigje të pasakta, të paplota, të rreme ose pengojnë inspektimin e parashikuar në nenin 36;</p> <p>d) heqin vulat e vëna në autorizimin zyrtar të Autoritetit, sipas nenit 36 shkronja "ç" të këtij ligji;</p> <p>dh) nuk njofton një përqendrim, sipas neneve 10 dhe 12 të këtij ligji;</p> <p>e) bëjnë ftesë për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, sipas nenit 4/1 të këtij ligji.</p> <p>2. Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17 zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<p>3. Moszbatimi i pikës 1 të nenit 34 të këtij ligji nga ana e organit të administratës qendrore e vendore apo i institucionit publik, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën 50 000 lekë.</p>	
			Neni 33	<p>Masa e gjobës për shkelje të rënda</p> <p>1. Komisioni vendos gjoba, në masën deri në 10 për qind të xhiros së ndërmarrjes, të vitit financiar paraardhës, për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse që:</p> <p>a) shkel nenet 4 e 9 të këtij ligji;</p> <p>b) nuk zbaton vendimin për marrjen e masave të përkohshme, sipas nenit 44;</p> <p>c) nuk përmbush kushtet dhe detyrimet në mbështetje të një vendimi të marrë, sipas neneve 45, 50 pika 2, 56, 57 dhe 60 pika 2 të këtij ligji;</p> <p>ç)</p> <p>d) realizon një përqendrim i cili ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg, duke mos respektuar detyrimin e nenit 14, përveç rastit</p>	<p>Pika 2 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit.</p>

				<p>kur realizimi i përqendrimit është autorizuar shprehimisht, sipas nenit 60 të këtij ligji;</p> <p>dh) realizon një përqendrim të ndaluar nga Komisioni ose nuk merr masat e nevojshme për rivendosjen e konkurrencës, sipas nenit 62 të këtij ligji.</p> <p>2. Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17, të këtij ligji, zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale.</p>		
			Neni 34	<p style="text-align: center;">Lehtësimi nga gjobat</p> <p>1. Një ndërmarrjeje, të përfshirë bashkë me të tjerat në një marrëveshje të ndaluar, sipas nenit 4, mund t'i jepet lehtësimi, i plotë ose i pjesshëm, nga gjobat, nëse ajo ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së ndaluar, si dhe në përcaktimin e personave përgjegjës, duke siguruar të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti.</p> <p>Lehtësimi i plotë nga gjoba nuk do t'u jepet ndërmarrjeve që kanë ndërmarrë veprime për të detyruar ndërmarrjet e tjera për t'u bashkuar</p>		<p>Shtesa e bërë në pikën 1 është masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit.</p>

				<p>në një marrëveshje të ndaluar ose për të qëndruar në të.</p> <p>2. Komisioni u jep ndërmarrjeve këshillë për lehtësim nga gjobat, duke treguar edhe kushtet për zbatimin e saj, të përcaktuara në “Rregulloren për gjobat dhe lehtësimin e tyre”. Kjo këshillë u transmetohet ndërmarrjeve dhe nuk publikohet.</p> <p>3. Në rastin e një vendimi, Komisioni mund të japë lehtësim nga gjobat në përpjesëtim me kontributin e dhënë për zbardhjen, zbulimin dhe ndalimin e shkeljes, nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në këshillën për lehtësim.</p>		
			Neni 35	<p style="text-align: center;">Sanksione individuale</p> <p>1. Pavarësisht gjobës së vendosur në bazë të neneve 73 dhe 74 të këtij ligji, Komisioni mund të vendosë gjoba në masën deri në 5 milionë lekë mbi individët, që kryejnë ose bashkëpunojnë në kryerjen e veprimeve që përbëjnë kundravajtje administrative sipas neneve 73 pika 1 dhe 74 pika 1 të këtij ligji.</p>		Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit

				<i>2. shfuqizohet</i>		
Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”, Neni 25	<p>Neni 25</p> <p>Afatet e parashkrimit për vendosjen e gjobave</p> <p>1. Kompetencat e dhëna për Komisionin në zbatim të neneve 23 dhe 24, i nënshtrohen periudhave të parashkrimit si në vijim:</p> <p>a) tre vjet në rastin e shkeljeve të dispozitave në lidhje me kërkesat për informacion ose me zhvillimin e inspektimeve;</p> <p>b) pesë vjet në rastin e të gjitha shkeljeve të tjera.</p> <p>2. Parashkrimi duhet të llogaritet që nga dita në të cilën është kryer shkelja. Gjithsesi, në rastin e shkeljeve të vazhdueshme ose të përsëritura, parashkrimi duhet të fillojë të llogaritet në ditën në të cilën shkelja ndërpritet.</p> <p>3. Çdo veprim i ndërmarrë nga</p>		Neni 36	<p>Afatet e parashkrimit për vendosjen e gjobave</p> <p>1. Kompetencat e Komisionit për vendosjen e gjobave në zbatim të neneve 73 dhe 74 i'u nënshtrohen periudhave të parashkrimit si në vijim:</p> <p>a) 3 vjet në rastin e shkeljeve të dispozitave në lidhje me kërkesat për informacion ose me zhvillimin e inspektimeve;</p> <p>b) 5 vjet në rastin e të gjitha shkeljeve të tjera.</p> <p>2. Afati i parashkrimit llogaritet që nga dita në të cilën është kryer shkelja. Gjithsesi, në rastin e shkeljeve të vazhdueshme ose të përsëritura, parashkrimi duhet të fillojë të llogaritet nga dita në të cilën shkelja ndërpritet.</p> <p>3. Çdo veprim i ndërmarrë nga Autoriteti i Konkurrencës për qëllim të hetimit ose të procedurave në lidhje me një shkelje, do të ndërpresë periudhën e parashkrimit për vendosjen e gjobave ose gjobave periodike. Periudha e parashkrimit duhet të ndërpritet nga</p>	E plotë	

	<p>Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar për qëllimin e hetimit ose të procedurave në lidhje me një shkelje, do të ndërpresë periudhën e parashkrimit për vendosjen e gjobave ose pagesave periodike. Periudha e parashkrimit duhet të ndërpritet nga data në të cilën veprimi i është njoftuar të paktën një ndërmarrje ose grupimi ndërmarrjesh që ka marrë pjesë në shkelje. Veprimet që ndërpresin ecurinë e periudhës përfshijnë veçanërisht sa vijon</p> <p>a) kërkesat e shkruara për informacion nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;</p> <p>b) autorizimet me shkrim për të kryer inspektime, të lëshuara për nëpunësit e tij nga Komisioni ose nga</p>			<p>data në të cilën veprimi i Autoritetit i është njoftuar të paktën një ndërmarrje ose grupimi ndërmarrjesh që ka marrë pjesë në shkelje. Veprimet që ndërpresin ecurinë e periudhës përfshijnë veçanërisht sa vijon, por jo vetëm:</p> <p>a) kërkesat me shkrim për informacion nga Autoriteti i Konkurrencës;</p> <p>b) autorizimet me shkrim për të kryer inspektime, të lëshuara për nëpunësit e tij nga Komisioni i Konkurrencës;</p> <p>c) fillimi i procedurave nga Autoriteti i Konkurrencës;</p> <p>d) njoftimi i raportit hetimor nga Autoriteti i Konkurrencës.</p> <p>4. Ndërprerja e afatit të parashkrimit duhet të zbatohet për të gjitha ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në shkelje.</p> <p>5. Çdo ndërprerje do të rinovojë afatin e parashkrimit përsëri. Pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, afati i parashkrimit përfundon në ditën në të cilën ka kaluar një periudhë e barabartë me dyfishin e afatit të parashkrimit, pa</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	<p>autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;</p> <p>c) fillimi i procedurave nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;</p> <p>d) njoftimi i deklaratës së kundërshtimeve nga Komisioni ose nga autoriteti i konkurrencës së një Shteti Anëtar;</p> <p>4. Ndërprerja e afatit të parashkrimi duhet të zbatohet për të gjitha ndërmarrjet ose grupimet e ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në shkelje.</p> <p>5. Çdo ndërprerje do të rinovojë afatin e parashkrimit përsëri. Megjithatë, periudha e parashkrimit përfundon më së voni në ditën në të cilën ka kaluar një periudhë e barabartë me dyfishin e periudhës së parashkrimit, pa u vendosur nga Komisioni një gjobë ose një gjobë periodike. Ky afat duhet</p>			<p>u vendosur një gjobë ose një gjobë periodike nga Komisioni.</p>		
--	---	--	--	--	--	--

	<p>të shtrihet nga koha gjatë së cilës parashkrimi është pezulluar në përputhje me paragrafin 6.</p> <p>6. Afati i parashkrimit për vendosjen e gjobave ose gjobave periodike pezullohet për aq kohë sa vendimi i Komisionit është objekt i procedimit në Gjykatën e Drejtësisë.</p>					
<p>Rregullorja e Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”, Neni 26</p>	<p>Neni 26</p> <p>Afati i parashkrimit për ekzekutimin e gjobave</p> <p>1. Kompetenca e Komisionit për të zbatuar vendimet e marra në përputhje me nenet 23 dhe 24 do t'i nënshtrohet një afati parashkrimi prej pesë vjetësh.</p> <p>2. Parashkrimi nis të llogaritet në ditën në të cilën vendimi merr formë të prerë.</p>		<p>Neni 37</p>	<p>Afati i parashkrimit për ekzekutimin e gjobave</p> <p>1. Kompetenca e Autoritetit të Konkurrencës për të ekzekutuar një gjobë të vendosur në përputhje me nenet 73 dhe 74 të këtij ligji do t'i nënshtrohet një afati parashkrimi prej 5 vjetësh.</p> <p>2. Parashkrimi nis të llogaritet nga dita në të cilën vendimi merr formë të prerë.</p> <p>3. Afati i parashkrimit për ekzekutimin e sanksioneve do të ndërpritet:</p> <p>a) me njoftimin e një vendimi që ndryshon shumë filltare të</p>	<p>E plotë</p>	

	<p>3. Afati i parashkrimit për ekzekutimin e sanksioneve do të ndërpritet:</p> <p>(a) me njoftimin e një vendimi që ndryshon shumën fillestare të gjobës ose pagesës periodike të gjobës ose refuzon një kërkesë për ndryshim;</p> <p>(b) me çdo veprim të Komisionit ose të një Shteti Anëtar, që vepron me kërkesë të Komisionit, i përcaktuar për të zbatuar pagesën e gjobës ose pagesën periodike të gjobës.</p> <p>4. Çdo ndërprerje do të rinovojë parashkrimin përsëri.</p> <p>5. Afati i parashkrimit për zbatimin e gjobave pezullohet për aq kohë sa:</p> <p>(a) lejohet afati për t'u paguar;</p> <p>(b) ekzekutimi i pagesës është pezulluar në</p>			<p>gjobës ose pagesës periodike të gjobës ose refuzon një kërkesë për ndryshim;</p> <p>b) me çdo veprim të Komisionit, i përcaktuar për të zbatuar pagesën e gjobës ose pagesën periodike të gjobës.</p> <p>4. Çdo ndërprerje do të rinovojë afatin e parashkrimit përsëri.</p> <p>5. Afati i parashkrimit për zbatimin e gjobave pezullohet për aq kohë sa:</p> <p>a) lejohet afati për t'u paguar;</p> <p>b) ekzekutimi i pagesës është pezulluar në bazë të një vendimi gjyqësor.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

	mbështetje të një vendimi të Gjykatës së Drejtësisë					
			Neni 38	<p style="text-align: center;">Ankimi</p> <p>1. Kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit për vendimin.</p> <p>2. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.</p>		Masë e brendshme kombëtare që ndihmon në zbatimin e projektligjit
			Neni 39	Nenet 81, 82, 83, 84 shfuqizohen		Shfuqizohen dispozita kalimtare
			Neni 40	Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.		